



Funded by
the European Union

Rritja e çmimeve në Kosovë

dhe masat e mundshme për përballimin e inflacionit



Janar 2022

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

Rritja e çmimeve në Kosovë dhe masat e mundshme për zbutjen e efektit të inflacionit

Janar 2022

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

— Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	3
Hyrje	4
Inflacioni në Kosovë: krahasim i indekseve	5
Rritja e çmimeve dhe niveli i pagave në Kosovë	10
Përfundim dhe rekomandime	12
Aneks	13



Funded by
the European Union

KOSOVO 2.0

gap INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE

Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2021, me hapjen e ekonomisë, në Kosovë ngjashëm me vendet tjera, filloi rikuperimi nga kriza ekonomike, ku vetëm gjatë tremujorit të dytë rritja reale e BPV në baza tremujore ishte 16.3 përqind. Ky zhvillim pozitiv erdhi si rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme, pakove fiskale të rimëkëmbjes nga Qeveria, dhe mbështetjes nga diaspora. Me rritjen e aktivitetit ekonomik, u vërejt edhe një rritje në nivelin e çmimeve. Gjatë vitit 2021, indeksi i çmimeve të konsumit ishte në rritje të vazhdueshme, duke rezultuar në një rritje mesatare vjetore prej 3.1 përqind, deri në nëntor të këtij viti.

Në këtë analizë, janë paraqitur katër indekset e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për matjen e nivelit të çmimeve dhe këto janë: indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit (IHÇK), indeksi i çmimeve të prodhimit, indeksi i çmimeve të importit dhe indeksi i kostos së ndërtimit. Këto indekse janë analizuar për një periudhë dhjetë vjeçare, si dhe në bazë të kategorive të tyre. Sipas të dhënave të paraqitura, gjatë vitit 2021, përveç indeksit të çmimeve të konsumit, vërehet rritje edhe në indekset e tjera. Më konkretisht, indeksi i çmimeve të prodhimit kishte rritje mesatare vjetore prej 4.2 përqind (periudha janar-shtator), indeksi i çmimeve të importit 8.3 përqind (janar-shtator), dhe ai i kostos së ndërtimit 10.9 përqind (janar-shtator).

Në mënyrë që të bëhet një analizë më e plotë, në këtë raport është analizuar edhe niveli i pagave në Kosovë, dhe është bërë krahasimi me nivelin e çmimeve. Kjo është realizuar përmes indeksimit të mesatares vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit dhe pagës neto bazuar në vitin 2012. Sipas kësaj analize, mund të konkludohet se fuqia blerëse e konsumatorëve përgjatë viteve është rritur. Megjithatë, duhet të ceket që në këtë indeksim nuk janë përfshirë edhe të dhënat e vitit 2021.

Bazuar në të gjeturat e këtij raporti, disa nga rekomandimet e mundshme për zbutjen e efektit të rritjes së çmimeve janë: rritja e pagës minimale, siç është e përcaktuar me legjislacionin në fuqi, rritja e pagesave për përfituesit e skemave sociale, dhe funksionalizimi i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe intensifikimi i monitorimit të tregjeve për 'marrëveshjet e fshehura'. Një tjetër rekomandim në aspektin teknik është të analizohet diskrepanca në mes të indekseve (ai i çmimeve të konsumit me atë të çmimeve të importit) si dhe të analizohen peshat e përdorura në kategoritë e IÇK, dhe të përshtaten me aktivitetin ekonomik të periudhës përkatëse.

Hyrje

Kriza ekonomike globale e shkaktuar si pasojë e pandemisë COVID-19 gjatë vitit 2020, u vërejt edhe në Kosovë, ku Bruto Produkti Vendor (BPV) pësoi një rënie vjetore prej 5.3 përqind.¹ Rikuperimi nga kriza ekonomike filloi me hapjen e ekonomisë, ku në tremujorin e parë të vitit 2021, rritja reale e BPV në baza tremujore ishte 4.2 përqind. Të dhënat e fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), tregojnë për një përmirësim të dukshëm të situatës ekonomike në tremujorin e dytë të vitit 2021, sipas të cilave, rritja reale e BPV në baza tremujore ishte 16.3 përqind.²

Zhvillimet pozitive ekonomike ishin si rrjedhojë e rritjes së kërkesës së brendshme, pakove fiskale për rimëkëmbje të Qeverisë së Kosovës, si dhe mbështetjes nga diaspora. Më konkretisht, një nga stimuluesit kryesor të konsumit, remitencat, deri në tetor të vitit 2021, shënuan rritje vjetore prej 20 përqind, duke arritur vlerën 956 milionë euro për periudhën janar – tetor 2021.³ Një tjetër stimulues i rritjes së BPV-së gjatë 2021, ishte eksporti i mallrave dhe shërbimeve. Eksporti i mallrave shënoi rritje gjatë kësaj periudhe, dhe deri në fund të muajit tetor 2021, arriti vlerën prej 613.9 milionë euro. Kjo vlerë krahasuar me gjithsej eksportin e mallrave në vitin 2019 dhe 2020 është dukshëm më e lartë (eksporti në vitin 2019 dhe 2020 ishte 383.5 dhe 474.9 milionë euro respektivisht). Në këtë rritje disa nga faktorët që patën ndikim janë: rritja e eksportit të artikujve të ndryshëm të prodhuar (mobilitet, krevatet, dyshekët, etj.), më shumë se dyfish duke arritur vlerën 119 milionë euro deri në tetor 2021, rritja e eksportit të metaleve bazë dhe artikujve të tyre, produkteve minerale dhe disa kategorive të tjera.⁴ Tutje, edhe eksporti i shërbimeve shënoi rritje duke arritur vlerën prej 1.59 miliardë euro deri në fund të muajit shtator. Në këtë vlerë, rritjen më të madhe e kishte kategoria e shërbimeve të udhëtimit (që përfshin shpenzimet e diasporës), me një vlerë prej 1.26 miliardë euro.⁵

Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2020, i shkaktuar kryesisht nga rënia e kërkesës së brendshme si pasojë e pandemisë, ndikoi edhe në dinamikat e inflacionit. Gjatë vitit 2020, në Kosovë kishte rënie të nivelit të çmimeve të konsumit dhe norma mesatare vjetore ishte 0.2 përqind. Megjithatë, me rikuperimin e aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2021, vërehet rritje edhe në nivelin e çmimeve. Në nivel global, rritja e çmimeve erdhi si pasojë e mos-përputhjes së kërkesës dhe ofertës gjatë pandemisë, rritjes së çmimeve të mallrave bazë dhe zhvillimeve të ndryshme të politikave. Në tregun e mallrave bazë, kishte një rritje prej rreth 14 përqind në çmimet e naftës deri në gusht të vitit 2021 në nivel global, dhe rritje prej rreth 10 përqind në çmimet e metaleve për të njejtën periudhë. Tutje, pati një rritje prej rreth 11 përqind edhe në çmimet e ushqimeve dhe pijeve të prodhuesve, duke rritur kështu rrezikun e rritjes së çmimeve të konsumit. Sipas parashikimeve bazë të FMN-së, inflacioni pritet të ketë rënie gjatë vitit 2022 dhe të kthehet në nivelin e njejtë sikur para periudhës së pandemisë. Megjithatë, në disa shtete në zhvillim, efekti i vonuar i çmimeve më të larta të ushqimit dhe naftës si importuese, mund të shkaktojë që çmimet të vazhdojnë të mbeten në atë nivel edhe gjatë vitit 2022.⁶

Marrë parasysh faktin që Kosova është një ekonomi e vogël dhe e hapur ndaj faktorëve të jashtëm, mund të vërehet që presionet e inflacionit të barten edhe tek ne. Kjo kryesisht vjen si rrjedhojë që Kosova është një vend importues i mallrave, dhe si rezultat, rritja e çmimeve të importit përkthehet edhe në shportën e konsumatorit. Mesatarja vjetore⁷ e indeksit të çmimeve në Kosovë për vitin 2021 (periudha janar – nëntor) ishte 3.1 përqind, ku vetëm gjatë muajit nëntor ishte 6.9 përqind.⁸ Ngjashëm, në shtetet e Eurozonës, kjo mesatare gjatë vitit 2021, deri në muajin nëntor, ishte 2.4 përqind. Nëse krahasohet me shtetet e rajonit, Serbia dhe Maqedonia e Veriut kanë një mesatare pak më të lartë prej 3.4 dhe 3.9 përqind respektivisht.⁹


- 1 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021), Bruto Produkti Vendor (BPV) sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve 2008–2020. Burimi: <https://bit.ly/320hg2k>
- 2 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021), Bruto Produkti Vendor (BPV) TM2 2021. Burimi: <https://bit.ly/3remUGC>
- 3 Banka Qendrore e Kosovës (2021), Seritë Kohore: Dërgesat e emigrantëve. Burimi: <https://bit.ly/3qoySy1>
- 4 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021), Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme. Burimi: <https://bit.ly/3Ji5CRb>
- 5 Banka Qendrore e Kosovës (2021), Seritë Kohore: Bilanci i pagesave. Burimi: <https://bit.ly/3mCLH5K>
- 6 International Monetary Fund (2021), World Economic Outlook October 2021. Burimi: <https://bit.ly/3FqS3f4>
- 7 Në këtë raport, mesatarja vjetore është llogaritur periudha janar – nëntor e çdo viti, në mungesë të të dhënave të muajit dhjetor për vitin 2021
- 8 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021), Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHCK). Burimi: <https://bit.ly/3GHPETp>
- 9 Eurostat (2021), Harmonised Indices of Consumer Prices (HICP). Burimi: <https://bit.ly/3qn2iMX>

Inflacioni në Kosovë: krahasim i indekseve

Dinamikat e nivelit të çmimeve në Kosovë maten nga katër indekse të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, e këto janë: indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit (IHÇK), indeksi i çmimeve të prodhimit, indeksi i çmimeve të importit dhe indeksi i kostos së ndërtimit. Në mënyrë që kjo analizë të jetë sa më gjithëpërfshirëse, më poshtë kemi shikuar veç e veç lëvizjet e këtyre katër indekseve.

Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit (IHÇK) në Kosovë përgjatë viteve ka pasur luhatje të vogla, duke qëndruar në nivel mesatarisht të njejtë. Për një periudhë dhjetë vjeçare (2011–2021), mesatarja vjetore ishte 1.9 përqind, ndërsa norma më e lartë e rritjes ishte në vitin 2011 me 7.7 përqind, dhe më e ulëta në vitin 2015, me -0.6 përqind. Gjatë vitit 2020, si pasojë e rënies së aktivitetit ekonomik, për shkak të pandemisë, norma e rritjes së çmimeve ishte vetëm 0.2 përqind.

Grafikoni 1. Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit për periudhën 2011–2021



Gjatë vitit 2021, rritja e kërkesës së brendshme dhe zhvillimet globale të inflacionit, u përkthyen në rritje të vazhdueshme të nivelit të çmimeve në baza mujore. Si rrjedhojë, norma më e lartë ishte gjatë muajit nëntor, në nivel prej 6.9 përqind (ndryshimi vjetor krahasuar me periudhën e njejtë të vitit të kaluar). Mesatarja vjetore gjatë këtij viti (periudha janar-nëntor) është 3.1 përqind (shih Grafikonin 1).¹⁰

Burimi:
Agjencia e Statistikave të
Kosovës (2021)


Nëse analizohet IHÇK sipas kategorive të konsumit gjatë vitit 2021, vërehet se kategoria me rritjen më të lartë të çmimeve është ajo e mjeteve të komunikimit, me rritje mesatare prej 16.3 përqind. Tutje, dy kategori tjera me rritje më të lartë janë ajo e transportit dhe ajo e pijeve alkoolike dhe duhanit, me 7.7 dhe 3.2 përqind, respektivisht (shih Grafikonin 2). Të dhënat e fundit të muajit nëntor 2021, tregojnë për një rritje të vazhdueshme të çmimeve edhe për kategorinë e ushqimit dhe pijeve joalkoolike, ku vetëm gjatë muajit të fundit, norma e rritjes ishte 6.7 përqind.¹¹ Marrë në konsideratë faktin që kategoria e ushqimit dhe pijeve është një nga kategoritë esenciale për konsum, dhe si e tillë është

¹⁰ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021), Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Burimi: <https://bit.ly/3GHpETp>

¹¹ Ibid

gjithmonë pjesë e shportës së konsumatorëve edhe kërkesa për të nuk ndikohet shumë nga çmimet (shih Aneks 1 për kategoritë dhe peshat e tyre në llogaritje të indeksit). Për këtë arsye, rritja e çmimeve në këtë kategori është e rëndësishme të analizohet, meqenëse ka ndikim tek të gjithë konsumatorët pa dallim.


Grafikoni 2. Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit për vitin 2021 sipas kategorive - ndryshimi vjetor %



Siç u përmend edhe më lartë, një faktor i rëndësishëm i rritjes së çmimeve të konsumit ishin edhe çmimet globale të konsumit, e rrjedhimisht të importit në Kosovë. Këtë e tregon më saktësisht edhe indeksi i çmimeve të importit që kalkulohet në baza tremujore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Vetëm gjatë tremujorit të tretë në vitin 2021, ndryshimi vjetor i çmimeve të importit kishte rritje prej 14.7 përqind, ndërsa mesatarja vjetore për këtë vit (janar-shtator 2021) është 8.3 përqind. Krahasuar me vitet e kaluara edhe para periudhës së pandemisë, kur rritja vjetore ishte mesatarisht rreth 2.5 përqind, kjo rritje është mjaft e lartë (Grafikoni 3).

Burimi:
Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021)


Grafikoni 3. Indeksi i çmimeve të importit për vitin 2021



Burimi:
Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021)

Në aspekt sektorial, kategoria e produkteve të importuara me rritjen më të lartë vjetore gjatë tremujorit të tretë (TM3) ishte ajo e metaleve bazë dhe artikujve të tyre, me rritje vjetore prej 56.9 përqind. Tutje, një kategori tjetër me rritje të lartë gjatë kësaj periudhe ishte ajo e produkteve minerale, me rritje vjetore prej 35.8 përqind, e përcjellur nga kategoria e plastikës, kauçukut dhe artikujve të tyre me 19.9 përqind. Dy kategori të tjera të produkteve të importit që kanë pasur rritje të çmimit janë ajo e vajrave ushqyese dhe ajo e instrumenteve optike, fotografike, matëse, medicinale e muzikore si dhe mekanizmave të orës, me 13.8 dhe 13.5 përqind, respektivisht.¹²

Grafikoni 4. Indeksi i çmimeve të importit për TM3 2021 sipas kategorive – ndryshimi vjetor %




Një çështje që lë hapësirë për hulumtim më të thellë, ndonëse nuk është brenda fokusit të këtij studimi, është edhe ndërlidhja në mes të indeksit të çmimeve të konsumit dhe atij të çmimeve të importit. Siç u përmend edhe më lartë, meqenëse mallrat e importuara përbëjnë një pjesë të madhe të konsumit, vërehet një diskrepancë në mes të këtyre dy indekseve, ku ai i konsumit është dukshëm më i ulët (2.3 përqind mesatarja vjetore deri në shtator të këtij viti, krahasuar me mesataren vjetore prej 8.3 përqind të indeksit të importit në të njëjtën periudhë). Ky dallim në mes të këtyre indekseve meriton hulumtim më të thellë, duke analizuar ndërlidhjen në mes të tyre si dhe masën me të cilën indeksi i çmimeve të importit ndikon IHÇK.

Burimi:
Agjencia e Statistikave të
Kosovës (2021)

Një tjetër indeks i çmimeve që do të analizohet në këtë raport është ai i çmimeve të prodhimit. Krahas indeksit të çmimeve të importit, i cili fokusohet në ndikimet inflacioniste nga jashtë, ky indeks bazohet në ndikimet nga brenda. Më konkretisht, ky indeks bën matjen e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara në vend nga ndërmarrjet prodhuese më reprezentative. Në këtë mënyrë, ky indeks bën matjen e lëvizjeve të çmimeve nga këndvështrimi i prodhuesve. Përgjatë viteve, ky indeks ka pasur luhataje të vogla duke filluar nga norma më e lartë e rritjes në vitin 2011 me 6.1 përqind, e deri tek ajo më e ulëta në vitin 2020 me -0.8 përqind. Mesatarja vjetore e ndryshimeve të këtij indeksi për një periudhë dhjetë vjeçare është 1.9 përqind (Grafikoni 5).

¹² Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021), Indeksi i Çmimeve të Importit. Burimi: <https://bit.ly/313LjFF>

Grafikoni 5. Indeksi i çmimeve të prodhimit për vitin 2021

Gjatë vitit 2021, ngjashëm me indekset tjera, të dhënat tregojnë se ka pasur një ngritje edhe në çmimet e prodhimit, me një mesatare vjetore prej 4.2 përqind (janar-shtator). Në baza tremujore, norma më e lartë e rritjes së çmimeve ishte në tremujorin e tretë të vitit 2021, prej 6.9 përqind.

Burimi:
Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021)

Në aspekt të veprimtarive ekonomike, rritjen më të lartë të çmimeve gjatë këtij tremujori e kishte kategoria e energjisë elektrike, gazit, avullit dhe furnizimit me ajër të kondicionuar, me normë 17 përqind. Tutje, rritje të çmimeve kishte edhe prodhimi i metaleve, prej 12.1 përqind, si dhe prodhimi i mobileve, prej 9 përqind (grafikoni 6).¹³


Grafikoni 6. Indeksi i çmimeve të prodhimit për TM3 2021 sipas kategorive - ndryshimi vjetor

Burimi:
Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021)

13 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021), Indeksi i Çmimeve të Prodhimit. Burimi: <https://bit.ly/34Sr67h>

Indeksi i fundit që do të analizohet në këtë analizë, është ai i kostos së ndërtimit. Ky indeks konsiderohet të jetë i rëndësishëm për analizë duke qenë se ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe përcakton çmimet e pronave të paluajtshme. Për më shumë, është relevant për ekonominë marrë parasysh që është sektori me më së shumti investime private, dhe njëkohësisht që përbën pjesën më të madhe të investimeve të huaja direkte. Ky indeks i cili kalkullohet në baza tremujore nga ASK nga viti 2014, ka për qëllim të bëjë matjen e çmimeve të faktorëve që bëjnë pjesë në kosto të ndërtimit. Këta faktorë përfshijnë: materialet (lëndët e para), pagat, makineritë, transporti, energjia, dhe kosto të tjera.

Grafikoni 7. Indeksi i kostos së ndërtimit për vitin 2021



Gjatë një periudhe gjashtë vjeçare (2014–2020), ky indeks ka qëndruar në nivel relativisht të ulët, me një rritje mesatare vjetore prej 0.5 përqind (Grafikoni 7). Megjithatë, ngjashëm me indekset e çmimeve të tjera, gjatë vitit 2021, vërehet një rritje e vazhdueshme e çmimeve të ndërtimit. Mesatarja vjetore e llogaritur për periudhën janar-shtator të vitit 2021 ishte 10.9 përqind. Nga kjo, rritja më e lartë ndodhi në tremujorin e tretë të vitit, ku norma e rritjes krahas periudhës së njëjtë të vitit të kaluar ishte 15.2 përqind.¹⁴

Burimi:
Agjencia e Statistikave të
Kosovës (2021)


Në bazë të kategorive të kostove të ndërtimit, të dhënat për TM3 2021 tregojnë që rritjen më të lartë e kishin materialet, me një normë të rritjes prej 20.5 përqind. Më konkretisht, në këtë kategori rritjen më të lartë e kishin materialet elektrike, me 25.9 përqind, dhe materialet ndërtimore, me 21.3 përqind. Për më shumë, rritje më të lartë të çmimeve kishte edhe energjia, me 17.1 përqind (Grafikoni 8). Rritje kishin edhe kategoritë tjera të kostove, mirëpo në nivel më të ulët. Sipas grafikoni të shfaqur më poshtë, rritja vjetore e kostove të tjera, makinerive, dhe pagave ishte 4.3, 3.4, dhe 2.2 përqind, respektivisht. Normë negative të rritjes kishin shpenzimet e transportit, me -2.8 përqind.¹⁵

¹⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021), Indeksi i Kostos së Ndërtimit. Burimi: <https://bit.ly/3qqNRrv>

¹⁵ Ibid

Grafikoni 8. Indeksi i kostos së ndërtimit për TM3 2021 sipas kategorive – ndryshimi vjetor

Burimi:
Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021)



Rritja e çmimeve dhe niveli i pagave në Kosovë

Në mënyrë që të bëhet një analizë më e plotë, në këtë raport do të analizohet edhe niveli i pagave në Kosovë, dhe do të krahasohet me nivelin e çmimeve. Për të realizuar këtë krahasim, është marrë për bazë paga mesatare neto dhe indeksi i çmimeve të konsumit. Ky indeks është zgjedhur meqenëse paraqet çmimet e shportës së konsumatorëve dhe duke e krahasuar me nivelin e pagave, mund të vlerësohet nëse ka pasur rritje apo rënie të fuqisë blerëse.


Sipas të dhënave të fundit nga ASK, paga mesatare neto në Kosovë në vitin 2020 ishte 416 euro, me rënie prej 3.3 përqind krahas vitit paraprak. Kjo erdhi si pasojë e rënies së aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2020, si dhe ndjeshmërisë së sektorit privat ndaj aktivitetit ekonomik. Në aspekt sektorial, paga mesatare neto më e lartë ishte në sektorin e ndërmarrjeve publike, në vlerë prej 680 euro, e përcjellur nga paga mesatare neto në sektorin publik në vlerë prej 552 euro, si dhe nga ajo e sektorit privat në vlerë prej 342 euro. Mesatarisht, gjatë periudhës 2013–2020, norma mesatare e rritjes së pagave neto për të gjithë sektorët ishte 2.3 përqind.¹⁶ Në anën tjetër, paga minimale gjatë një periudhe disa vjeçare ka qëndruar në nivel të njejtë. Sipas të dhënave nga ASK, paga minimale në Kosovë është 130 Euro për grupmoshën deri në 35 vjeç, dhe 170 Euro për grupmoshën mbi 35 vjeç.¹⁷

Për të krahasuar rritjen e pagave me atë të çmimeve përgjatë viteve, meqenëse të dhënat për pagat në ASK janë të publikuara nga viti 2012, ky vit është përdorur si vit bazë për këtë analizë. Në këtë mënyrë, është bërë indeksi i mesatares vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe pagës neto bazuar në vitin 2012 (indeksi = 100).

¹⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës, (2021), Niveli i pagës mesatare sipas vitit. Burimi: <https://bit.ly/3qBJYPn>

¹⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021), Niveli i pagave në Kosovë. Burimi: <https://bit.ly/3rm6Mmi>

Grafikoni 9. Pagat dhe çmimet të indeksuara në vitin 2012



Sipas të dhënave të shfaqura në Grafikonin 9, vërehet se të gjithë indekset kanë pasur rritje përgjatë viteve (përfshirë vitin 2020). Dy indekset më të larta në vitin 2020 janë ato të nivelit të pagave neto të sektorit publik dhe atij të ndërmarrjeve publike, me vlerë prej 150.8 dhe 135.5 respektivisht. Tek këta dy sektorë, rritja më e lartë ishte në vitin 2014, kur edhe hyri në fuqi vendimi për rritje të pagave në sektorin publik. Tutje, ndonëse indeksi i pagave të sektorit privat është më i ulët, vërehet një rritje më e theksuar në periudhën 2017–2019. Nga këto indekse, vlerën më të ulët e ka indeksi i çmimeve të konsumit, me vlerë prej 107.5. Nëse krahasohet me indeksin e pagës mesatare neto për të gjithë sektorët (në vlerë prej 119.5), vërehet se niveli i pagave është më i lartë se ai i çmimeve përgjatë viteve. Sipas kësaj, mund të konkludohet se fuqia blerëse, apo të hyrat diskrecionale (discretionary income),¹⁸ të konsumatorëve përgjatë viteve janë rritur. Megjithatë, duhet të ceket që në këtë analizë nuk janë përfshirë edhe të dhënat e vitit 2021 e të cilat mund të shfaqin rezultate më ndryshe për shkak të ndryshimeve të ndodhura në vitin 2021 siç u elaborua më lartë.

Një çështje që mund të ketë ndikim në llogaritjen e indeksit të çmimeve të konsumit dhe të hapësirë për analizë më të thellë, është edhe llogaritja e peshave të kategorive të produkteve dhe shërbimeve në kalkulimin e indeksit. Ndër vite, peshat e përdorura sipas kategorive kanë pasur ndryshime të vogla, pavarësisht situatës ekonomike. Kjo mund të vërehet edhe tek periudha 2019–2021, për shembull ku kategoria e transportit dhe ajo e shëndetësisë kanë një peshë relativisht të njëjtë në të tri vitet. Marrë parasysh se gjatë vitit 2020, një pjesë e vitit për qytetarët ishte në izolim, është e pritshme që ka pasur rënie të dukshme në përdorimin e shërbimeve të transportit. Ngjashëm, tek shërbimet e shëndetësisë, marrë parasysh situatën me pandeminë, ka pasur rritje të përdorimit të këtyre shërbimeve. Për këtë arsye, është e rëndësishme që edhe pesha e përdorur në kalkulimin final të indeksit për disa kategori, të jetë në linjë me situatën aktuale ekonomike. Kjo është e rëndësishme në mënyrë që të shmanget mbivlerësimi ose nënvlerësimi i nivelit të çmimeve.

¹⁸ Të hyrat diskrecionale, apo në anglisht 'discretionary income' janë të hyrat e mbetura pas taksave dhe shpenzimeve të domosdoshme.

Burimi:
Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021),

Kalkulimet:
Instituti GAP

Përfundim dhe rekomandime

Si përfundim, gjatë këtij viti, edhe në Kosovë, si në vendet tjera, pati rritje të nivelit të çmimeve, marrë parasysh faktin që Kosova është një ekonomi e vogël dhe ndikohet nga presionet e jashtme. Kjo rritje e çmimeve erdhi si rrjedhojë e mos-përputhjes së kërkesës dhe ofertës gjatë pandemisë, dhe rikuperimit të aktivitetit ekonomik pas periudhës së mbylljes nga pandemia. Indeksi i çmimeve të konsumit gjatë vitit 2021 në Kosovë ishte në rritje të vazhdueshme, me një rritje mesatare vjetore prej 3.1 përqind deri në muajin nëntor. Rritja e çmimeve vërehet edhe në indekset e tjera të çmimeve, ku indeksi i çmimeve të importit kishte rritje mesatare vjetore prej 8.3 përqind, ai i çmimeve të prodhimit 4.2 përqind, dhe ai i kostos së ndërtimit 10.9 përqind.

Nëse analizohet niveli i pagave në Kosovë, vërehet se tek paga mesatare neto ka pasur ndryshime përgjatë viteve, ndërsa paga minimale ka qëndruar në nivel të njejtë. Bazuar në indeksimin e pagave neto sipas sektorëve dhe mesatares vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit të paraqitur në këtë studim, konkludohet se përgjatë viteve niveli i pagave ka pasur rritje më të lartë se ai i çmimeve, dhe rrjedhimisht, fuqia blerëse e konsumatorëve është rritur (në këtë kalkulim nuk janë përfshirë të dhënat e vitit 2021). Në anën tjetër, paga minimale ka qëndruar në nivel të njejtë.

Marrë parasysh çështjet e diskutuara më lartë, një rekomandim i mundshëm për zbutjen e efektit të rritjes së çmimeve në bazë të kësaj analize është rritja e pagës minimale. Edhe pse me Udhëzimin Administrativ për caktimin e pagës minimale parashihet që qeveria bazuar në rekomandimet e Këshillit Ekonomik-Social, në fund të secilit vit të përcaktojë pagën minimale bazuar në disa faktorë, një gjë e tillë nuk ka ndodhur deri tash. Prandaj, rekomandohet që të zbatohet legjislacioni në fuqi lidhur me përcaktimin e pagës minimale, dhe në bazë vjetore të bëhet rishikimi sipas faktorëve të përcaktuar me këtë legjislacion, e që janë: kostoja e shpenzimeve jetësore, shkalla e papunësisë, gjendja në tregun e punës, dhe shkalla e konkurrencës dhe produktivitetit në vend.¹⁹ Megjithatë, duhet pasur parasysh faktin që rritja e pagës minimale mund të ketë ndikim në rritje të mëtutjeshme të çmimeve, meqenëse ka rritje të të hyrave dhe kërkesës.

Një tjetër rekomandim është rritja e pagesave për përfituesit e skemave sociale. Përkundër faktit se këto pagesa kanë pasur rritje në vitin 2018, dhe gjithashtu ka pasur shtesa si përgjigje ndaj pandemisë në vitin 2020 dhe 2021, prapë se prapë këto pagesa për rastet sociale janë më të ulëta se sa që parashihet me kufirin e varfërisë (sidomos tek familjet me më shumë se pesë anëtarë).

Me rritjen e çmimeve ka pasur ankesa nga qytetarët dhe janë shfaqur dyshime se ekzistojnë 'marrëveshje të fshehura' të fiksimit të çmimeve nga prodhuesit dhe bizneset, qoftë të produkteve (rritja e çmimit të bukës) apo të shërbimeve (rritja e çmimit të shërbimeve të floktarëve).²⁰ Lidhur me këto dyshime, rekomandohet që Autoriteti Kosovar i Konkurrencës fillimisht të funksionalizohet, marrë parasysh faktin që nuk ka ende drejtues pas skadimit të mandatit të kryetarit aktual dhe anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës më 9 qershor 2021, si dhe të intensifikohet monitorimi i tregjeve për 'marrëveshjet e fshehura'.

Krejt në fund, janë edhe dy rekomandime që kanë të bëjnë me llogaritjen e indeksit të çmimeve. Njëra ka të bëjë me diskrepancën në mes të indekseve: norma e rritjes së indeksit të çmimeve të konsumit është shumë më e ulët se sa ajo e indeksit të importit (ndonëse është e ditur se një pjesë e madhe e shportës së konsumatorit është e përbërë nga produktet e importuara). Dhe tjetra, ka të bëjë me peshat e njëjta të përdorura në kategoritë e IÇK, duke mos marrë parasysh rëndien në aktivitet ekonomik të disa kategorive. Prandaj, institucionet përkatëse duhet të marrin parasysh këto çështje dhe të përmirësojnë metodologjitë e kalkulimit të këtyre indekseve.

19 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2017), Udhëzim Administrativ (MPMS) nr. 09/ 2017 për kriteret dhe procedurën e përcaktimit të pagës minimale në Republikën e Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/33bx82F>

20 Koha (2021), Qytetarët në Ferizaj ankohen për rritjen e çmimeve të produkteve ushqimore. Burimi: <https://bit.ly/3rlmlkZ>

Aneks


Aneks 1. Peshat e përdorura në IÇK sipas kodit, grupet dhe nëngrupet

		2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
00	Gjithsej IÇK	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
01	Ushqimi dhe pijet joalkoolike	42.7	37.8	37.8	38.2	40.9	39.2	37.6	39.8	40.0	40.1	39.9
01.1	Ushqimi	38.5	34.9	34.9	35.1	37.1	33.9	32.1	33.9	34.7	34.7	33.6
01.1.1	Buka dhe drithërat	10.1	7.8	7.8	7.5	9.2	8.3	8.2	10.1	10.2	10.2	8.8
01.1.2	Mishi	8.1	7.7	7.7	8.0	8.8	11.0	10.5	10.6	10.4	10.4	9.8
01.1.3	Peshqit	0.5	0.6	0.6	0.6	0.3	0.4	0.3	0.3	0.2	0.3	0.3
01.1.4	Qumështi, djathi dhe vezët	5.3	6.9	6.9	7.1	9.1	5.3	5.3	5.2	5.6	5.4	5.9
01.1.5	Vajërat dhe yndyrat	2.6	1.5	1.5	1.6	1.0	1.1	0.8	0.7	0.8	0.6	0.6
01.1.6	Pemët	2.7	2.5	2.5	2.5	1.8	1.7	1.6	1.8	2.0	2.2	2.3
01.1.7	Perimet	4.6	4.7	4.7	4.7	4.4	3.7	3.1	3.1	3.3	3.3	3.7
01.1.8	Sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat	2.3	2.3	2.3	2.3	1.8	1.7	1.5	1.4	1.4	1.4	1.3
01.1.9	Prodhimet ushqimore	2.3	0.9	0.9	0.9	0.7	0.9	0.8	0.8	0.8	0.9	0.9
01.2	Pijet joalkoolike	4.2	3.0	3.0	3.1	3.8	5.3	5.5	5.9	5.3	5.4	6.3
01.2.1	Kafja, çaji dhe kakao	1.6	0.8	0.8	1.0	1.3	1.2	1.3	1.1	1.1	1.1	1.2
01.2.2	Uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet	2.6	2.2	2.2	2.1	2.5	4.2	4.2	4.7	4.2	4.2	5.1
02	Pijet alkoolike, duhani	8.0	5.2	5.2	5.4	5.2	5.2	5.4	5.7	5.6	5.7	6.4
02.1	Pijet alkoolike	1.3	1.0	1.0	1.0	1.3	1.9	2.5	2.6	2.5	2.5	2.9
02.2	Duhani	6.7	4.2	4.2	4.4	3.9	3.2	2.9	3.2	3.1	3.2	3.6
03	Veshje dhe këpucë	11.7	7.2	7.2	6.3	4.5	4.5	4.4	3.9	3.8	4.1	4.2
03.1	Veshje	7.9	5.5	5.5	4.7	3.2	3.4	3.4	3.0	2.9	3.1	3.2
03.2	Këpucë	3.8	1.7	1.7	1.5	1.3	1.1	1.0	0.9	0.9	1.0	1.0
04	Strehimi , uji, rryma, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	10.5	7.1	7.1	7.6	8.9	7.9	7.6	7.3	7.7	7.7	7.8
04.1	Pagesa aktuale për banim	0.8	0.3	0.3	0.4	0.6	0.6	0.6	0.6	0.6	0.6	0.5
04.3	Mirëmbajtja dhe rregullimi i vendbanimit	0.8	1.1	1.1	1.1	0.6	0.6	1.1	0.9	0.9	0.9	0.9
04.4	Furnizimi me ujë dhe shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin	1.0	0.9	0.9	1.0	1.2	1.2	1.3	1.3	1.1	1.1	1.3

		2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
04.5	Rryma, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	7.9	4.8	4.8	5.2	6.6	5.5	4.5	4.5	5.2	5.1	5.1
05	Orenditë, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	4.6	10.0	10.0	10.0	8.5	8.7	8.9	8.3	7.9	7.6	7.7
05.1	Orenditë dhe aparaturat, qilimat dhe shtrojat tjera për dysheme	0.7	2.3	2.3	2.9	1.8	2.4	2.1	1.9	1.9	1.8	1.7
05.2	Tekstilet për amvisëri	0.5	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3	0.4	0.4
05.3	Pajisjet shtëpiake	0.5	1.5	1.5	1.6	1.5	1.4	1.5	1.5	1.6	1.5	1.4
05.4	Qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës	0.5	1.1	1.1	1.1	0.9	1.0	1.4	1.3	1.3	1.2	1.4
05.5	Veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht	0.2	2.1	2.1	1.4	1.3	1.5	1.5	1.5	1.0	1.0	1.4
05.6	Mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake	2.2	2.8	2.8	2.7	2.7	2.1	2.1	1.9	1.7	1.7	1.5
06	Shëndetësia	2.9	3.3	3.3	3.3	2.8	3.4	3.1	2.7	2.5	2.1	2.1
06.1	Prodhimet dhe pajisjet mjekësore	2.0	1.7	1.7	1.7	2.1	2.2	1.9	1.6	1.4	1.2	1.2
06.2	Shërbimet ambulatore	0.8	0.6	0.6	0.8	0.5	0.8	1.1	1.0	1.0	0.8	0.8
06.3	Shërbimet spitalore	0.1	0.9	0.9	0.7	0.2	0.3	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
07	Transporti	8.1	13.4	13.4	13.5	13.1	13.1	14.4	15.1	15.4	15.7	15.8
07.1	Blerja e automjeteve	0.6	3.9	3.9	3.9	3.5	3.8	4.7	5.2	5.5	5.7	6.0
07.2	Përdorimi i pajisjeve për transportin personal	5.6	7.9	7.9	8.2	8.3	7.3	7.4	7.6	7.6	7.8	7.9
07.3	Shërbimet për transport	1.9	1.6	1.6	1.4	1.3	2.0	2.3	2.3	2.3	2.2	1.9
08	Mjetet e komunikimit	2.4	3.4	3.4	3.3	3.2	3.8	4.0	3.7	3.7	3.8	3.3
08.1	Shërbimet postare	0.2	0.0	0.0	0.2	0.6	0.3	0.3	0.3	0.2	0.3	0.2
08.x	Pajisjet telefonike dhe të telefaksit dhe shërbimet telefonike dhe të telefaksit	2.2	3.4	3.4	3.1	2.5	3.5	3.7	3.4	3.4	3.5	3.1
09	Rekracioni dhe kultura	1.7	4.5	4.5	4.5	4.5	4.6	5.0	4.7	4.4	4.4	4.2
09.1	Pajisjet audio-vizuale, fotografike dhe për përpunimin e informatave	0.2	1.2	1.2	1.2	1.1	1.1	1.3	1.2	1.1	1.1	1.0
09.2	Pajisjet tjera të qëndrueshme për rekreacion dhe kulturë	0.0	0.3	0.3	0.3	0.2	0.3	0.3	0.3	0.2	0.2	0.2

		2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
09.3	Gjërat dhe pjesjet tjera rekreative, kopshtet dhe manarët	0.3	1.3	1.3	1.1	1.0	0.9	0.9	1.0	0.8	0.8	0.8
09.4	Shërbimet rekreative dhe kulturore	0.2	0.3	0.3	0.3	0.9	0.6	0.6	0.6	0.6	0.6	0.7
09.5	Gazetat, librat dhe materialet për zyra	0.9	1.4	1.4	1.1	1.0	1.3	1.4	1.2	1.1	1.1	1.1
09.6	Pushime të organizuara	0.1	0.0	0.0	0.5	0.4	0.4	0.4	0.5	0.6	0.6	0.6
10	Arsimi	1.6	1.1	1.1	1.1	1.3	1.2	1.2	1.0	1.0	1.0	1.0
11	Restorantet dhe hotelet	2.3	4.1	4.1	3.9	3.4	3.5	3.2	2.8	3.1	3.2	3.1
11.1	Shërbimet hoteliere	1.6	3.2	3.2	3.0	2.7	2.8	2.7	2.4	2.8	2.9	2.8
11.2	Shërbimet për strehim	0.7	0.9	0.9	1.0	0.6	0.7	0.5	0.4	0.3	0.4	0.3
12	Mallrat dhe shërbimet e ndryshme	3.6	3.0	3.0	3.1	3.8	4.9	5.3	5.0	4.9	4.5	4.6
12.1	Kujdesi personal	2.4	1.6	1.6	1.6	1.5	1.6	1.6	1.5	1.7	1.6	1.7
12.3	Gjërat personale	0.3	0.1	0.1	0.2	0.6	0.8	1.2	1.3	1.1	1.0	0.9
12.4	Mbrojtja sociale	0.1	:	:	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
12.5	Sigurimet	0.4	0.2	0.2	0.2	0.7	1.1	1.1	0.8	0.7	0.8	0.8
12.6	Shërbimet financiare	0.1	0.9	0.9	0.7	0.5	1.0	1.0	0.9	1.0	0.8	0.9
12.7	Shërbimet tjera	0.3	0.2	0.2	0.2	0.5	0.4	0.4	0.3	0.3	0.3	0.3

Burimi:
Agjencia e Statistikave të
Kosovës (2021)






Funded by
the European Union

Projekti "Inovacioni për mediat e
qëndrueshme dhe angazhimin qytetar"
i financuar nga BE, implementohet nga:

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

KOSOVO 2.0

